



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2021

VENDIM
Nr. 489, datë 19.10.2021

PËR
TRANSFERIMIN E PËRKOSSHËM ME PËLQIM NË GJYKATËN
ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË VLORË TË GJYQTARES,
ZNJ. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61 dhe në shkronjën “c”, të nenit 86, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikën 1, të nenit 46, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 9, të Vendimit të tij nr. 23, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, i ndryshuar, pasi shqyrtoi kërkesat e gjyqtarëve që kanë dhënë pëlqimin për transferim të përkohshëm, znj. {...} dhe znj. {...}, mbi propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë të gjyqtares znj. {...}, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin.
2. Efektet juridike të transferimit të përkohshëm fillojnë më datë 25.10.2021.
3. Gjyqtarja {...} përjashtohet menjëherë nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.
4. Gjyqtarja Ema Shaholli ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet gjyqësore që ka në gjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, si gjyqtar i vetëm, kryetar ose anëtar i trupit gjykues, për të cilat ka filluar shqyrtimi gjyqësor, si dhe ato në çdo gjykatë tjetër e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Çështjet e tjera gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë dorëzohen menjëherë prej saj.
5. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.
6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së transferuar përkohësisht znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR